



Raporti për konsultimin publik me qytetarë për: “Projekt-buxhetin e komunës për vitin vijues 2022 ”

REPublika E KOSOVËS
REPublika KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

Kronologji e shkurtër e konsultimit:

-III- Nr. I prot. 3341 Më 29.06 2021
Br. prot. Dt. 29.06 2021
RAHOVEC - ORAHOVAC

Me 10/06/2021, është publikuar njoftimi për organizimin e konsultimit publik për **Projekt-buxhetin e komunës për vitin vijues 2022**. Njoftimin e publikuar në uebfaqe mund të gjeni në këtë vegëz: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2021/06/Njoftim-per-organizimin-e-konsultimit-publik-me-qytetare-per-Projekt-buxhetin-e-komunes-per-vitin-vijues-2022.pdf>.

Njoftimin si lajm mund të gjeni në këtë vegëz: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/news/njoftim-per-organizimin-e-konsultimit-publik-me-qytetare-per-projekt-buxhetin-e-komunes-per-vitin-vijues-2022/> ,

Njoftimi në të njëjtën ditë është publikuar edhe në Platformën e Konsultimeve Publike, njoftimin e publikuar mund të gjeni në vegëzën: <http://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=41118> , njoftimi gjithashtu është publikuar edhe në facebookun zyrtar të komunës.

Rikujtimet e publikuar në uebfaqe:

1.Me18/06/2021, <https://kk.rks-gov.net/rahovec/news/rikujtim-njoftim-per-organizimin-e-konsultimit-publik-me-qytetare-per-projekt-buxhetin-e-komunes-per-vitin-vijues-2022-2/>.

2.Me 23/06/2021, <https://kk.rks-gov.net/rahovec/news/rikujtim-njoftim-per-organizimin-e-konsultimit-publik-me-qytetare-per-projekt-buxhetin-e-komunes-per-vitin-vijues-2022/> .

3.Me 24/06/2020, <https://kk.rks-gov.net/rahovec/news/rikujtim-njoftim-per-organizimin-e-konsultimit-publik-me-qytetare-per-projekt-buxhetin-e-komunes-per-vitin-vijues-2022-3/>.

Njoftimet dhe rikujtimet e publikuara në facebook:

Njoftim

Me 10/06/2021, është publikuar njoftimi:
<https://www.facebook.com/119273741483824/posts/4110122645732227/>.

Rikujtime

1 Me 23/06/2021, <https://www.facebook.com/119273741483824/posts/4145241132220378/>.

2 Me 24/06/2021, <https://www.facebook.com/119273741483824/posts/4148689721875519/>.

3 Me 25/06/2021, <https://www.facebook.com/119273741483824/posts/4150961074981717/>.

Me 25/06/2021, është mbajtur konsultimi, në këtë vegëz mund të gjenilajmin e publikuar për mbajtjen e konsultimit: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/news/mbahet-konsultim-publik-per-projekt-buxhetin-e-komunes-se-rahovecit-per-vitin-vijues-2022/>, në këtë vegëz: <https://www.facebook.com/rahoveckomuna/posts/4151570704920754>


Zyrtër pjesëmarrës në konsultim ishin: Afrim Dina, kryesues i kuvendit komunal dhe kryesues i Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF); Afrim Limani, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa; Qendresa Duraku, zyrtare për Marrëdhëne me Publikun (Kabineti i Kryetarit); Haziz Krasniqi, Zyrtar për Informim; Skender Hamza, Udhëheqës i Zyrës së Kuvendit; Rasim Fazliu, anëtar i KPF-së, Dërvish Çadraku, anëtar i KPF-së; Florida Bajraktari, anëtare e KPF-së; Fjolla Duraku, anëtare e KPF-së; Bajram Morina, asambleist; Përparim Krasniqi, drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike; Saranda Sallteku, drejtoreshë e Administratës së Përgjithshme; Fehmi Cena, anëtar i KPF-së; Artan Asllani, drejtor i Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm.

Në konsultim kanë marrë pjesë: 17 qytetarë, 3 femra dhe 14 meshkuj, pjesë e konsultimit kanë qenë edhe 14 zyrtarë komunalë si anëtar të KPF-së dhe drejtorë të drejtorive komunale.

Organizimi i këtij konsultimi publik është bërë nga kryesuesi i Kuvendit Komunal dhe kryesues i Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF), Afrim Dina dhe anëtarët tjerë të KPF-së.

Bashkangjitur në këtë raport janë: njoftimi për organizimin e konsultimit publik, lista e nënshkrimeve të qytetarëve pjesëmarrës në konsultim, lista e zyrtarëve pjesëmarrës në konsultim publik dhe Kornizen Afatmesme Buxhetore (KAB) e Komunës së Rahovecit të Përgatitur nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dokumenti KAB gjatë konsultimit u është shpërndarë edhe qytetarëve të pranishëm në konsultim.

Përgatiti:


Haziz Krasniqi

Data: 29/06/2021



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi i Komunës Rahovec

Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec

Njësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 208 Nr. i faq/Br.str/No.pg 1

Data/Datum/Date 05 / 06 / 2021

Në bazë të nenit 68 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), dhe nenit 92 paragrafi 1, nenit 17,18,19,20,21 dhe 22 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2021 si dhe nenit 6 pika 1.2 Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna kryesuesi i Kuvendit Komunal të Rahovecit në bashkëpunim me Zyrën për Informim organizon:

Njoftim
Konsultim Publik

Qytetarë të nderuar të komunës së Rahovecit, ju ftojmë të merrni pjesë në **KONSULTIMIN** Publik për Projekt-buxhetin e komunës për vitin vijues 2022. Ky konsultim publik, organizohet nga kryesuesi i Kuvendit Komunal, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) dhe Zyra Për Informim.

Konsultimi Publik do të mbahet me **25.06.2021** (e premte) në sallën e mbledhjeve të Kuvendit Komunal të Rahovecit me fillim në ora **10:00**. Të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjithë qytetarët e komunës së Rahovecit.

Në këtë vegëz: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2021/05/Qarkorja-2022-01-SHQ.pdf>, mund të gjeni Qarkoren e parë Buxhetore 2022-2024.


Jeni të mirëseardhur!

01 Nr. 205/21
Rahovec: 10.06.2021





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kuvendi Komunal Rahovec
Skupština Opštine Orahovac
Municipal Assembly Rahovec



Lista e qytetarëve pjesëmarrës në konsultimin publik për **Projekt-buxhetin e komunës për vitin vijues 2022.**

Nr	Emri	Mbiemri	Vendi	Nënshkrimi
1	KURAT	KRYEZIU	XËRXË	
2	TEKI	MUSTAFA	LAGA 2 RAHOVEC	
3	Muhamet	MORINA	DEJANË	
4	Shëndet	Khosrovi	OPTERUSHË	
5	EDMIR	SOKOLI	RAHOVEC TH	
6	Ymer	Thajrullaj	LAGA 1 - RAHOVEC	
7	MASAN	SHAKA	HOGEC VOGEË	
8	Beton	Khosrovi	POSTOJ	
9	Homani	Qulaku	OPTERUSHË	
10	AZEM	LUSHI	M. VOGEË	
11	FATON	FETAHAJ	GURU KRAJ	
12	ARTA	KABASHI	RIPLAK	
13	GËRMIA	GASHI	RAHOVEC	
14	VJOLLCA	BERISHA	RATKOC	
15	HEXHEMIN	KRISHIÇI	GEXHË	
16	Zymer	Arifaj	GEXHË	
17	ARBEN	GASHI	SARAJE	
18				
19				
20				
21				
22				
23				
24				



Republika e Kosovës
 Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
 Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kuvendi Komunal Rahovec
 Skupština Opštine Orahovac
 Municipal Assembly Rahovec



Lista e zyrtarëve pjesëmarrës në konsultimin publik për **Projekt-buxhetin e komunës për vitin vijues 2022.**

Nr	Emri	Mbiemri	Pozita	Nr.Tel	Nënshkrimi
1	Afrim	Lima	Kryesues	044-339-035	
2	Afrim	Lima	Deputet B.F.	044/219-638	
3	Qendresa	Duraku	Kabineti i Kuvendit	044/230-803	
4	HAZIR	KRASHI	ZYRTAR PËR INFORMIM	044-183-117	
5	Shender	Hamza	Udh. Sek. Kuvendit	044/269/750	
6	Rasim	Fazli	KPF-anëtar	044 165617	
7	Seniob	Çelroshi	an KPF	044 161 334	
8	Florida	Bajraktari	KPF-anëtar	—	
9	Fjolla	Duraku	KPF	—	
10	Bajram	Morina	Asambleist	049-777 019	
11	PERPARIM	KRASHI	DREKTOR	044/315-261	
12	Sananda	Sallku	DREKTORESH	045/134-002	
13	Fehmi	Çena	Anemblesist	044/202-660	
14	ARTAN	ASLANI	DREKTOR BZHT	044/546 630	
15					

Përgatiti: HAZIR KRASHI

Nënshkrimi:

Data: 25/06/2021



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit / Opština Oraovac / Municipality of Rahovec



**KORNIZA AFATMESME
BUXHETORE (KAB)
E KOMUNËS SË RAHOVECIT
2022-2024**

Drejtoria për Buxhet dhe Financa

2021

Përmbajtja:


Përmbajtja:.....	1
I. Hyrje	2
II. Strategjia Zhvillimore Komunale - Deklarata e Prioriteteve Afatmesme	3
1. Forcimi i ekonomisë komunale me mundësi për të gjithë përmes:.....	4
2. Forcimi i sektorit të bujqësisë	5
3. Përmirësimi i infrastrukturës shkollore dhe veprime që synojnë rritjen e cilësisë në arsim.....	6
4. Përmirësimi i shëndetësisë dhe mirëqenies së qytetarëve	6
1. Përmirësimi dhe mbrojtja e mjedisit, planifikimi urban dhe shërbimet publike komunale	7
2. Përcaktim i përhershëm i yni është:.....	7
3. Rinia, kultura dhe sporti	8
III. Korniza Fiskale Komunale.....	8
3.1 Indikatorët ekonomik komunal	8
3.2 Të Hyrat Komunale dhe Parashikimi Afatmesëm 2022-2024	10
3.3 Tendencat e shpenzimeve komunale dhe parashikimi i tyre afat-mesëm 2022-2024	13
3.4 Analiza Gjinore	20

I. Hyrje

Korniza Afatmesme Buxhetore KAB që po prezantojmë, është një dokument i cili miratohet në parim çdo vit nga Asambleja Komunale. Ky material siguron një analizë të hollësishme të shpenzimeve publike dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit vjetor komunal. Gjithashtu KAB siguron mekanizmat e nevojshëm për arritjen e objektivave, prioritetëve, të identifikuar në dokumentet strategjike të komunës, përmes integritetit sa më të mirë në procesin buxhetor.

Kuadri Ligjor: Hartimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore përbën një detyrim për institucionet buxhetore komunale të kërkuar nga Qarkoret Buxhetore Komunale 2022/01, të lëshuara nga Ministria e Financave në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP).

Ky dokument do të jetë bazë për përcaktimin e sektorëve prioritet të zhvillimit dhe identifikimin e prioritetëve të shpërndarjes së burimeve komunale për periudhën 2022-2024. Janë katër faza të përmbledhura për zhvillimin e KAB komunal dhe afatet kohore, si në figurën e mëposhtme:





III

Publikimi i Dokumentit të KAB-it 2022-2024

Fundi i Qershorit



IV

Procesi vjetor i buxhetit 2021

II. Strategjia Zhvillimore Komunale - Deklarata e Prioriteteve Afatmesme

Komuna e Rahovecit gjendet në pjesën jugore të Kosovës, në rajonin e Dukagjinit (gjegjësisht në subrajonin e Anadrinit). Është njëra nga komunat e mesme me popullsi, pozita gjeografike i mundëson asaj lidhje të mira me qendra të tjera të Kosovës dhe të rajonit. Komuna e Rahovecit ka gjithsej 33 fshatra, 2 vendbanime dhe një qendër urbane e ndarë në 5 lagje, me një popullsi prej 56,208 banorë, sipas regjistrimit të vitit 2011, e organizuar në 8.028 ekonomi familjare.

Mbi 2475 biznese operojnë brenda komunës sonë, bazuar në të dhënat e Zyrës për Regjistrim të Bizneseve në komunën e Rahovecit, afërsisht gjysma e tyre (50%) merren me veprimtari tregtare, 15% në sektorin e shërbimeve, rreth 16% në prodhimtari, 19% me transport etj.

Administrata e Komunës së Rahovecit është e organizuar përmes zyrave qendrore dhe zyrave lokale, që ofrojnë shërbime në nivel të komunitetit, nga të cilat një është e vendosur në ndërtesën administrative të Komunës dhe 8 të tjera në fshatra, gjithashtu Komuna e Rahovecit posedon edhe E-kioskun, një mundësi e mirë që qytetarëve ju mundëson vetë-shërbimin me dokumente administrative (certifikata të ndryshme).

Vizioni i mëposhtëm për komunën e Rahovecit, i definuar pas konsultimeve me akterët e rëndësishëm të jetës politike, ekonomike e sociale në komunë bazohet edhe në dokumentet afatmesme dhe afatgjatë strategjike që ka zhvilluar komuna, siç janë: Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH) 2022-2024 të Qeverisë së Kosovës dhe prioriteteve bazë të saj, si dhe në Qarkoren Buxhetore Komunale 2022-2024 (I), të lëshuar nga Ministria e Financave e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Për tri vitet e ardhshme, vizioni i komunës së Rahovecit është: *të jetë qendër e zhvillimit ekonomik, me një bujqësi të zhvilluar, infrastrukturë të rregulluar, me plane zhvillimore dhe urbane, shërbime shëndetësore efikase dhe cilësore, komunë e integruar në proceset rajonale dhe ndërkombëtare, e afirmuar si një qendër e kulturës, arsimit dhe jetës sportive. Poashtu, një komunë e zhvilluar, e fortë dhe me shërbime publike, administrative që ofrojnë cilësi të mirë të jetesës për të gjithë qytetarët e saj.*

Atributet më të rëndësishme të çfarëdo dokumenti të planifikimit strategjik dhe vizionit të definuar janë, së pari lehtësia e komunikimit si dhe së dyti, llogaridhënia. Me qëllim të përmbushjes së këtyre dy attributeve të ndërlidhura njëra me tjetrën, prioritetet strategjike të komunës në periudhën afatmesme janë grupuar në pesë, e që do të mundësojnë realizimin e qëllimit e të vizionit tonë për komunën.

Këto prioritete janë:

1. Forcimi i ekonomisë komunale me mundësi për të gjithë përmes:

- Aftësimi i Zonës Ekonomike në Opterushë dhe hapësirave tjera për zhvillim.
- Lehtësira në të bërit biznes.
- Mbështetja direkte dhe indirekte e bizneseve.
- Mbështetja e turizmit dhe agroturizmit.
- Rritja dhe modernizimi i tregjeve.
- Këshilla dhe sugjerime në të bërit biznes.
- Investime në infrastrukturë publike, në zona potenciale për zhvillim ekonomik.
- Investime në zona turistike
- Bashkëpunimi ndërmjet sektorit publiko-privat
- Promovimi i turizmit në komunën e Rahovecit.

2. Forcimi i sektorit të bujqësisë

Zhvillimi dhe fuqizimi i sektorit të bujqësisë për të rritur bazën ekonomike dhe sociale në komunën tonë.

Strategjia për zhvillimin e bujqësisë duke e harmonizuar me politikat dhe strategjinë e hartuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Në kuadër të strategjisë do të përfshihen të gjithë sektorët që zhvillohen në komunën tonë me theks te veçantë: vreshtaria dhe perimekultura.

Në kuadër të strategjisë do të përfshihen programe të veçanta që do të ndikojnë direkt në përmirësimin e kushteve të punës për fermerët kultivues të pemëve dhe perimeve. Do vazhdojnë të kenë rolin kryesor projektet që prekin direkt fermerët si:

- Përkrahje bujqve dhe fermerëve me mekanizëm bujqësor, duke i klasifikuar për secilin sektor si:
- Perimekulturë dhe pemëtari - mekanizëm bujqësor (motokultivator të vegjël, spërkatëse, frezë, plug, etj.), komora ftohëse, makineri për tharje të bimëve mjekuese aromatike, inkubator etj.
- Investime në sipërfaqe të mbrojtura – serra (sipërfaqe 3 ari, 5 ari, 7 ari e deri në 10 ari, do të shohim mundësinë që kjo sipërfaqe të rritet në vazhdimësi)
- Përkrahje fermerëve me farëra, pleh kimik, pajisje bujqësore dhe me inpute bujqësore,
- Sektori i blegtorisë - përkrahje në makina mjelëse, stalla dhe ferma të vogla, shërbime veterinare (vaksinimi, kontrolla e kafshëve, repelimi etj.)
- Marrja e mostrave të tokave bujqësore për analiza
- Sektori i bletarisë - koshere për bletë, pajisje për trajtim dhe ruajtje të mjaltit, centrifugë etj.,
- Sektori i vreshtarisë - inventar për trajtim të rrushit pas vjeljes,
- Sektori i verëtarisë- pajisje për prodhuesit dhe inventar.
- Një theks i veçantë për këtë sektor do të bie në: këshillime dhe hartim të projekteve për fermerët, në sigurim të tregut për fermerë etj.
- Fuqizimi i qendrave grumbulluese dhe përpunuese të pemëve dhe perimeve,
- Fuqizimi dhe përkrahja e bodrumeve për përpunimin e rrushit,
- Hapjen e tregjeve të reja në lokalitete të komunës sonë si: funksionalizim i tregjeve në Krushë të Madhe, Ratkoc, kushte më të mira në tregun ekzistues në Xërxë, ndërtimin e 2 tregjeve të reja në qytetin e Rahovecit, po ashtu vazhdimin e fazës së tretë të projektit “Infrastruktura e tregut të rrushit” - te Shtëpia e Verës,
- Këshillimi i fermerëve dhe marrja përsipër e përgatitjes së të gjitha dokumenteve dhe planeve të biznesit për aplikim në institucione të ndryshme,
- Në bashkëpunim me zyrën këshillimore, që operon në kuadër të MBPZHR-së organizimin e trajnimeve për të gjithë sektorët e bujqësisë në komunën tonë,
- Organizimi i festivaleve të ndryshme që kane karakter promovimin e produkteve bujqësore që kultivohen në komunën tonë, si: Festa e Vjeljes së Rrushit –HardhFest, Agrofesta, panaire të ndryshme etj.

- Mbrojtjen e tokave bujqësore nga degradimi – erozioni, Menaxhimi me kujdes i tokës bujqësore komunale, duke i respektuar procedurat për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme përmes ankandit publik
- Fuqizimi i qendrave grumbulluese të qumështit, stimulimi i tyre.
- Ndërtimin e rrugëve fushore, me theks te veçantë mirëmbajtja e tyre,
- Ndërtimin e kanaleve të kullimit në zonat ku paraqiten vërshimet që rrezikojnë tokat bujqësore,
- Pastrimin dhe zgjerimin e përrrenjve që krijojnë probleme të vazhdueshme për fermerë,
- Drenazhimi i tokave bujqësore,
- Rrjeti sekondar i sistemit të ujitjes në lokacione ku ekziston rrjeti primar, si dhe zgjerimi i rrjetit në pjesën kodrinore në koordinim me kompanitë publike për sigurim të ujit për ujitje.
- Krijimin e fondit për Emergjencë etj.

Në sektorin e pylltarisë, do t'i jepet prioritet pyllëzimit të hapësirave të reja në tërë territorin e komunës. Toka e cila është nën menaxhim të Agjensionit Pyjor të Kosovës (APK) do të trajtohet me shumë kujdes dhe nuk do të lejohet degradimi dhe keqpërdorimi i saj.

3. Përmirësimi i infrastrukturës shkollore dhe veprime që synojnë rritjen e cilësisë në arsim

- Investime në përmirësimin e kushteve infrastrukturore të shkollave në funksion të rritjes së cilësisë në arsim.
- Efiçienca e energjisë në shkolla, sipas nevojave.
- Investime në mjete konkretizimi e laboratorike, teknologji informative dhe furnizime të bibliotekave shkollore me libra.
- Funksionalizimi i përhershëm dhe bashkëveprimi i organeve drejtuese të shkollave, këshillave drejtuese të shkollave, këshillave të prindërve dhe këshillave të nxënësve.
- Angazhimi i shërbimeve profesionale pedagogjike dhe psikologjike në shkolla.
- Angazhimi në ofrimin e trajnimeve profesionale të mësimmësuesve në funksion të rritjes së cilësisë në arsim.
- Monitorimi i vazhdueshëm i procesit edukativo arsimor në shkolla përmes Komisionit për Monitorim të themeluar nga DKA.
- Funksionalizimi i plotë i 3 çerdheve për fëmijë, të sapa ndërtuara.
- Organizimi dhe mbajtja periodike e garave të diturisë për nxënësit e të gjitha niveleve të arsimit parauniversitar.

4. Përmirësimi i shëndetësisë dhe mirëqenies së qytetarëve

- Riorganizimi i QKMF-së, për më shumë funksionalitet.
- Subvencionim për rastet e sëmundjeve për personat pa të ardhura/të ardhura të ulëta.
- Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore, ofrimi i shëndetësisë mobile.
- Krijimi i kushteve më të mira për stafin shëndetësor.
- Kujdesi paliativ, kujdesi shtëpiak.
- Parandalimi i sëmundjeve ngjitëse dhe jo ngjitëse.
- Parandalimi i sjelljeve të këqija si: droga, duhani dhe alkooli.
- Ofrimi i shërbimeve për të gjithë qytetarët në mënyrë të barabartë.
- Shtimi i personelit shëndetësor.

- Vizitat sistematike shëndetësore të nxënësve në shkolla. Rritja e shërbimeve laboratorike (shtimi i llojeve të analizave në QKMF).
- Rritja e shërbimeve specialistike në QKMF – këshillëdhënëse.
- Rehabilitimi i pacientëve me sëmundje mentale dhe ndihma për qytetarët për të pasur jetë të shëndetshme dhe aktive në komunitetin e tyre.
- Trajtimi i rasteve me Covid-19 dhe përkujdesja ndaj tyre në bashkëpunim me IKSHP-në dhe Klinikën Infektive.
- Ofrimi i shërbimeve mjekësore gjatë kohës së Pandemisë COVID-19 nga ekipet tona mjekësore në pikat kufitare (në rast nevojë) sipas kërkesës së Ministrisë së Shëndetësisë.
- Dezinfektimin dhe Dezinsektimi dhe Deratizimi i objekteve shëndetësore, Administratës Komunale dhe hapësirave publike.
- Krijimi i hapësirave për karantinë, (sëmundjet ngjitëse), objekti i QMF-së (në rast nevojë).
- Rritja e gamës së shërbimeve laboratorike.
- Furnizim me pajisje mjekësore për nevojat e QKMF-së me qëllim të ofrimit të shërbimeve sa më të mira për qytetarët e komunës sonë.
- Decentralizimi i shërbimeve mjekësore (QMF,AMF).

1. Përmirësimi dhe mbrojtja e mjedisit, planifikimi urban dhe shërbimet publike komunale

- Ndërtimi i rrugëve dhe trotuareve.
- Përmirësimi dhe rigjenerimi i infrastrukturës rrugore (sinjalizimi horizontal e vertikal, ndriçimi publik, mirëmbajtja dhe numërimi).
- Krijimi i shesheve të reja, parkingjeve dhe mirëmbajtja e tyre.
- Kolektori dhe impianti për trajtimin e ujërave të zeza.
- Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit.
- Eficienca e energjisë në objekte të sektorit publik.
- Menaxhimi i integruar i mbeturinave dhe riciklimi i tyre.
- Hartimi i planeve zhvillimore dhe urbane, hartimi i projekteve të tjera dhe mbikëqyrja e punimeve.
- Përkushtim dhe mirëmbajtje ndaj komplekseve përkujtimore, shtatoreve, varrezave dhe busteve të dëshmorëve, varrezave të martirëve dhe atyre civile.
- Përmirësimi i standardeve mjedisore.
- Përmirësimi dhe zgjerimi i ujit të pijshëm.
- Ofrimi i më shumë hapësirave të gjelbëruara dhe mirëmbajtja e tyre.
- Përmirësimi i gjendjes së lumenjve dhe përrenjve dhe trajtimi i shtretërve të tyre.
- Përkushtim ndaj të pastrehëve dhe familjeve në nevojë.
- Mbjellja e më shumë drunjve dekorativ dhe mirëmbajtja.

2. Përcaktim i përherëshëm i yni është:

- Qeverisje komunale e cila ofron shërbime efikase dhe që ju përgjigjet kërkesave të qytetarëve.
- Përmirësimi i vazhdueshëm i shërbimeve ndaj qytetarëve.
- Qasja sa më e afërt dhe e lehtë e qytetarëve në administratë.
- Ndërtimi dhe mirëmbajtja e zyrave komunale/gjendjes civile.
- Zgjerimi i sporteleve në zyrat e gjendjes civile.
- Sistemimi i zyrtarëve të zyrës së pranimit, kadastrës dhe arka, në një hapësirë të përbashkët, që kanë për qëllim shkurtimin e kohës për palët.

- Funksionalizimi i sporteve të veçanta për mërgatën.
- Vendorsja e E-Kiosk –ut për shërbimet e shpejta dhe efikase për palë, në njërin nga vendbanimet me të mëdha.

3. Rinia, kultura dhe sporti

- Përkrahja e aktiviteteve nga organizatat jo qeveritare kulturore e rinore.
- Mbështetja e të gjitha klubeve dhe shkollave sportive etj.
- Trajtimi dhe mirëmbajtja e palestrave të sporteve, fushave sportive dhe ndërtimi i terreneve të reja sportive dhe objekteve kulturore
- Funksionalizimi i Teatrit të Qytetit.
- Krijimi i rrjetit të OJQ-ve dhe mbështetje për to.
- Promovimi i projekteve për rini dhe kulturë.
- Intervenimi dhe restaurimi në monumentet kulturo-historike dhe mirëmbajtja e tyre.
- Pasurimi i fondit librar në bibliotekat e komunës sonë.

III. Korniza Fiskale Komunale

3.1 Indikatorët ekonomik komunal

Ndonëse komuna nuk udhëheq drejtpërdrejtë politikën makroekonomike (kjo është kompetencë e qeverisë qendrore), mjedisi i përgjithshëm ekonomik ndikon në pasqyrën fiskale komunale dhe si i tillë do të trajtohet si vijon, shih tabelën 1. Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës është në përputhje me Kornizën Makroekonomike të Kosovës dhe sipas dokumentit Korniza Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2022-2024 të përpiluar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Komponentët e politikës makroekonomike siç janë: Bruto Produkti Vendor, inflacioni dhe demografia duhet konsideruar dhe marrë parasysh. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2022-2024 e Qeverisë së Kosovës bazuar në të dhënat historike si dhe në zhvillimet e fundit ekonomike, nënvizon faktin se do të ketë ecuri pozitive të rritjes ekonomike në vitet e ardhshme, më saktësisht në periudhën 2022-2024 ku parashihet një rritje reale vjetore, **5.40 %** në vitin 2020, ndërsa rritja reale e Bruto produktit të vendit në 2022 - 2024 parashihet të jetë **4.10 %**, respektivisht **4.00 %**.

Natyrisht se rritja ekonomike ndryshe përkthehet edhe në krijimin e vendeve të reja të punës dhe zbutjen e papunësisë në komunë, që në periudhën afatmesme ulet me **1.65 %**, nga niveli i përgjithshëm i papunësisë që llogaritet të jetë i lartë.

Komuna nga ana e saj do të adaptojë legjislacionin përkatës në funksion të krijimit të ambientit më të mirë për sektorin privat dhe rritjes së të ardhurave të tyre, rrjedhimisht rritjes së të hyrave buxhetore komunale.

Aktualisht financimi komunal përfshin: **1. Të hyrat vetanake dhe 2. Grandet qeveritare**. Komunitat po ashtu janë pranues të grandeve të donatorëve të jashtëm dhe të brendshëm (me mbulim të plotë apo si pjesë të bashkëfinancimeve), si dhe kanë mundësinë e huamarrjes sipas kushteve të përcaktuara me legjislacionin në

fuqi. Komuna e Rahovecit në periudhën afatmesme buxhetore 2022-2024, nëse krijohen rrethanat, planifikon të marrë hua nga institucionet financiare për të financuar projektet e saj në projektet për menaxhimin e ujërave të zeza, eventualisht ndonji projekt tjetër me rëndësi strategjike për komunën tonë, për të cilën hua garantuese do të jetë Qeveria e Republikës së Kosovës, siç e ka lejuar Ligji për Financat Publike dhe Llogaridhënie.

Tabela 1: *Indikatorët ekonomik komunal*


Përshkrimi	2021	2022	2023 (vlerësimet)	2024 (vlerësimet)
Indikatorët makroekonomik në Kosovë				
Rritja reale e BPV në %	5.0	4.5	4.0	4.10
Inflacioni në %	1.90	1.20	1.00	1.00
BPV për kokë banori, në euro	7.243	7.658	8.033	8.458
Indikatorët ekonomik komunal				
Popullsia e Komunës	56.208	56.208	56.208	56.208
Numri i bizneseve të regjistruara	2.475	2.565	2.665	2.775
Numri i nxënësve	9.839	9,422	9,422	9,422

Burimi: Korniza Afatmesme e Shpenzimeve, Qeveria e Kosovës, 2022-2024

3.2 Të Hyrat Komunale dhe Parashikimi Afatmesëm 2022-2024

Të hyrat e Komunës së Rahovecit nga dy burimet e saj kryesore – grandet qeveritare si dhe të hyrat vetanake komunale kanë shënuar rritje nga viti në vit.

Paraqitja grafike 1: Buxheti Total i Komunës në vitet (2022 – 2024), milion Euro:



Në bazë të planifikimit të bërë nga viti 2021 grandet qeveritare për Komunën e Rahovecit si tërësi do të shënojnë rritje prej **4,16 %** në vitin 2022. Rritja e Grandit Qeveritar do të jetë **4.16 %** në vitin 2022 në krahasim me 2021, ndërsa të hyrat vetanake në vitin 2022 do të kenë një rritje prej: **27.27%** në krahasim me 2021.

Nga viti 2022-2024 parashihet një rritje prej **13.05 %** në tërësi, sipas të dhënave të prezantuara në tabelën 2 më poshtë, në Grandin qeveritar parashihet të ketë rritje prej **12.49 %** ndërsa në të hyrat vetanake **19,67 %** kjo rritje kryesisht bazohet në të dhënat e përgjithshme për rritjen buxhetore që planifikohet në nivel të Qeverisë Nacionale, siç parashihet me qarkoren 2022/01 (KASH 2022-2024).

Tabela 2: Planifikimi i të hyrave vetanake komunale sipas burimit për periudhën 2022-2024, në Euro

Burimi i të hyrave	2021	2022	2023	2024
Plani	1,061,093.00	1,350,548.00	1,458,405.00	1,522,116.00
Buxhet dhe Financa	584,593.00	792,117.00	829,617.00	875,000.00
Tatimi në Pronë	499,593.00	532,117.00	535,117.00	540,000.00
Tatimi në Tokë		170,000.00	204,000.00	244,000.00
Taksat rrugore	85,000.00	90,000.00	90,500.00	91,000.00
Administrata dhe Personeli	67,700.00	119,700.00	131,800.00	134,200.00
Taksa Çertifikatat e lindjes	14,500.00	14,000.00	16,000.00	16,500.00
Taksa Çertifikatat e kurorëzimit	5,000.00	9,000.00	12,000.00	13,000.00
Taksa Çertifikatat e vdekjes	1,000.00	1,500.00	1,600.00	1,700.00
Taksa Çertifikatat tjera ofiqarie	18,000.00	44,000.00	48,000.00	48,500.00
Takse për pjesëmarrje ne tender	200.00	200.00	300.00	500.00
Taksë për verifikimin e dokumenteve	1,000.00	1,000.00	2,500.00	2,500.00
Taksa tjera administrative	28,000.00	50,000.00	51,400.00	51,500.00
Inspekcioni	3,100.00	2,400.00	2,800.00	3,250.00
Gjobat nga inspektoriati	2,000.00	1,000.00	1,100.00	1,200.00
Licencë për pranimin e lokalit	1,000.00	900.00	1,100.00	1,300.00
Inspektimi higjienik dhe sanitar	100.00	500.00	600.00	750.00
Shërbime Publike	11,047.00	12,150.00	14,300.00	15,350.00
Taksa për leje gërmime	100.00	400.00	500.00	600.00
Të hyrat nga shitja e mbeturinave	0.00	0.00		
Shfrytëzimi i pronës publike	6,447.00	4,500.00	4,800.00	5,000.00
Qiraja nga vendosja e objekteve tregtare	500.00	4,700.00	5,500.00	6,000.00
Qiraja nga objektet publike	2,000.00	2,000.00	2,200.00	2,400.00
Licenca të lira individuale		250.00	300.00	350.00
Largimi dhe deponimi i automjeteve	2,000.00	300.00	1,000.00	1,000.00
Bujqësia dhe zhvillimi rural	89,100.00	72,000.00	75,800.00	76,616.00
Taksa -të hyrat nga pyjet	100.00	0.00	0.00	0.00
Shfrytëzimi i pronës publike(Qiraja e tokës bujqësore)	7,000.00	1,000.00	1,200.00	1,250.00
Participimet në bujqësi	80,000.00	70,000.00	73,000.00	73,716.00
Taksa për ndërrimin e destinimit të shfrytëzimit të tokës	2,000.00	1,000.00	1,600.00	1,650.00
Ekonomia dhe Zhvillimi	110,852.00	145,450.00	171,288.00	176,800.00
Licenca të lira individuale	900.00	0.00	0.00	0.00
Licenca për shërbime profesionale	100.00	150.00	250.00	300.00

Taksë për ushtrimin e veprimtarisë	80,852.00	65,000.00	66,000.00	66,500.00
Qiraja nga vendosja e objektit tregtar	29,000.00	80,300.00	105,038.00	110,000.00
Kadastër dhe Gjeodezia	48,000.00	42,000.00	45,000.00	47,000.00
Taksa për regjistrimin e trashëgimisë	25,000.00	24,000.00	25,000.00	26,000.00
Taksa për matjen e tokës në terren	23,000.00	18,000.00	20,000.00	21,000.00
Urbanizmi	56,501.00	91,531.00	110,600.00	113,700.00
Taksa komunale për leje ndërtimi	20,000.00	44,000.00	53,000.00	54,000.00
Taksa për demolim	500.00	1,000.00	1,100.00	1,200.00
Taksa për legalizimin e objekteve	28,001.00	38,531.00	45,000.00	46,000.00
Inspektimi respektimi i planit urbanistik	0.00	2,000.00	5,000.00	5,500.00
Leje mjedisore komunale	8,000.00	6,000.00	6,500.00	7,000.00
Shëndetësia dhe mirëqenien sociale	61,000.00	61,000.00	62,000.00	62,500.00
Participimi nga shëndetësia	61,000.00	61,000.00	62,000.00	62,500.00
Kulturë, Rini, Sport	4,200.00	1,000.00	2,000.00	2,500.00
Shitja e shërbimeve(Biblioteka)	4,200.00	1,000.00	2,000.00	2,500.00
Arsimi dhe Shkencë	25,000.00	11,200.00	13,200.00	15,200.00
Participimet -çerdhja e femijëve	10,000.00	11,000.00	13,000.00	15,000.00
Participimi në arsim	15,000.00	200.00	200.00	200.00

Komuna e Rahovecit vazhdon të dominohet në buxhetin total të saj nga transferet qeveritare të cilat edhe në tri vitet e ardhshme do të përbëjnë afërsisht 90 % të buxhetit total të komunës.

3.2.1 Donatorët e jashtëm (ndërkombëtarë)

Financimi nga donatorët e jashtëm dhe të brendshëm do të vazhdojnë edhe gjatë vitit 2022-2024 në shumë fusha si në arsim, Shëndetsi, infrastrukturë, Urbanizëm dhe mjedis, zhvillimin ekonomik etj.

3.2.2 Politikat e reja

Komuna e Rahovecit në tri vitet e ardhshme do të bëjë përpjekje në mobilizimin e resurseve komunale me qëllim të adoptimit të politikave të reja që ka iniciuar Qeveria Nacionale e Republikës së Kosovës, por edhe të atyre të iniciuara në nivelin e qeverisë komunale.

Fillimisht, ndonëse ende nuk është pjesë e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të Qeverisë së Kosovës 2022-2024, sugjerimit të Qeverisë së Kosovës janë që shuma e Grandit të Përgjithshëm të Komunave që aktualisht është dhjetë përqind (10%) e të hyrave totale buxhetore të Qeverisë Qendrore, (duke përjashtuar të hyrat nga shitja e aseteve, të hyrat tjera të jashtëzakonshme, të hyrat e dedikuara vetanake dhe të hyrat nga huamarrja) do të reduktohet në 9%, në vitet e ardhshme. Projeksionet e bëra për 2022 dhe 2024 në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve të Kosovës, nuk reflektojnë ende në këtë politikë. Për Komunën e Rahovecit kjo do të vazhdojë të jetë një risk që duhet trajtuar në të ardhmen dhe duke menduar strategjitë që duhet ndjekur me

qëllim të mbulimit të asaj difference që do të shkaktonte ulja e nivelit të Grandit të Përgjithshëm, për komunën.

Së dyti, në rast se në periudhën afatmesme Qeveria e Kosovës do të ndryshojë formulën shtetërore të ndarjes së grandit të arsimit për komuna, ndarje kjo që pretendohet të bëhet në bazë të normës e jo të numrit të nxënësve, atëherë kjo do të ketë ndikim të dukshëm në buxhetin e Komunës, ulë grandin e arsimit, sidomos duhet pas parasysh se ky grand përbën pjesën më të madhe të buxhetit komunal. Komuna nuk i ka informatat e nevojshme për të bërë analizën e impaktit të kësaj politike.

Së treti, komuna e Rahovecit ka mirëpritur deklaratimet e Qeverisë Nacionale, që në të ardhmen, sa i përket fleksibilitetit të shpenzimeve në të gjitha kategoritë ekonomike, përveç pagave, të kenë mundësi këtë ta bëjnë edhe nga Grandi i Përgjithshëm si shtesë, përveç se nga të hyrat vetanake komunale.

Ndërsa sa i përket të hyrave të tjera të Komunës, apo të hyrave vetanake, sërish Qeveria Nacionale ka shtyrë drejtë politikave të reja që do të orientonin komunën drejt avancimit të tatimeve me potencial të mirë dhe zbehjes, eventualisht eliminimit të atyre taksave e ngarkesave komunale që rëndojnë ambientin biznesor komunal. Edhe në të ardhmen barra kryesore në realizimin e hyrave vetanake bie mbi tatimin në pronë dhe në tatimin në tokë.

3.3 Tendencia e shpenzimeve komunale dhe parashikimi i tyre afat-mesëm 2022-2024

Sipas rekomandimeve të Misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar të komunikuar përmes Qarkores Buxhetore Komunale 2022/01 komunat do të kenë edhe në të ardhmen fleksibilitet në shpërndarjen e të hyrave vetanake komunale në strukturën e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike për vitin 2022, duke përjashtuar kategorinë Paga dhe Mëditje.:

Projeksionet e shpenzimeve buxhetore për vitin 2022 do ti paraqesim sipas kategorive ekonomike:

• Pagat dhe Mëditjet	7.872.844.00
• Mallrat dhe Shërbimet	1.735.000.00
• Shpenzimet Komunale	270.000.00
• Subvencionet dhe Transferet	360.000.00
• Shpenzimet Kapitale	4.815.786.00
TOTAL	15.053.630.00

3.3.1 Pagat dhe Mëditjet

Gjatë vitit 2022 krahasuar me vitin 2021, kjo kategori e shpenzimeve pritet të rritet **1.13 %** si rezultat i , pagesën e stazhit të punës . Pjesëmarrja e kategorisë së pagave dhe mëditjeve në shpenzimet e përgjithshme buxhetore komunale, gjatë këtyre viteve, pritet të mbetet në nivel të përafërt **52.29 %**.

3.3.2 Mallrat dhe Shërbimet

Kategoria e shpenzimeve për mallra dhe shërbime (duke përfshirë komunalit), është zvogëluar për **1.13 %** nga viti 2021 në vitin 2022. Pjesëmarrja e kësaj kategorie të shpenzimeve në shpenzimet e përgjithshme buxhetore, gjatë vitit 2022 pritet të jetë mesatarisht **13.31 %**.

3.3.3 Subvencionet

Në vitin 2022 komuna e Rahovecit do të ndajë subvencionet për bujqësi, Ekonomi, shëndetësi, arsim, kulturë, rini dhe sport. Gjatë vitit 2022 krahasuar me vitin 2021, kjo kategori e shpenzimeve pritet të rritet **15.76 %**. Pjesëmarrja e subvencioneve në shpenzimet e përgjithshme buxhetore gjatë vitit 2022 mesatarisht do të jetë **2.39 %**.

3.3.4 Investimet Kapitale

Kjo kategori e shpenzimeve do të shënojë rritje në vitin 2022, për **12.33 %** krahasuar me vitin 2021. Një pjesë e madhe e tyre planifikohet të financohet nga të hyrat vetanake të komunës. Pjesëmarrja e investimeve kapitale në totalin e shpenzimeve të komunës në vitin 2022 dhe tutje pritet të jetë mesatarisht: **31.99 %**.




Tabela 3: Korniza Buxhetore Komunale 2022-2024, në euro.

	Përshkrimi	2021	2022	2023	2024
			(plani)	(vlerësimet)	(vlerësimet)
1	TË HYRAT TOTALE KOMUNALE	14,216,590.00	15.053.630.00	15.813.281.00	16.582.931.00
	Të hyrat vetanake	1,061,093.00	1.350.548.00	1.458.405.00	1.522.116.00
	Grandet dhe transferet qeveritare	13,155,497.00	13.703.112.00	14.354.8765.00	15.060.815.00
2	SHPENZIMET TOTALE KOMUNALE	14,216,590.00	15,053,630.00	15,813,251.00	16,782,883.00
	Shpenzimet rrjedhëse	10,830,050.00	10,237,844.00	10,832,487	11,209,237.00
	Pagat dhe mëditjet	7,622,634.00	7,872,844.00	8,266,487.00	8,679,798.30
	Mallrat dhe shërbimet	1,715,477.00	1,735,000.00	1,805,000.00	1,857,439.30
	Shpenzimet komunale	280,500.00	270,000.00	381,000.00	282,000.00
	Subvencionet	311,000.00	360,000.00	380,000.00	390,000.00
3	Shpenzimet Kapitale	4,286,979.00	4,815,786.00	5,080,764.00	5,573,645.40
	Huamarrja e jashtme	0.00	0.00	0.00	0.00

Tabelat në vijim janë një pasqyrë e shpërndarjes së shpenzimeve në komunë në bazë të programeve apo kategorive funksionale si dhe në bazë të kategorive ekonomike. Shpenzimet në vijim (tabela 4) janë ato aktualet të vitit 2021, planifikimi për vitin 2022-2024 si dhe projeksionet përgatitjes në (Tabela 4-5-6-7).

Tabela 4: Shpenzimet në vitin 2021, të shpërndara në kategori ekonomike në programe dhe nën programe:

Programe	Paga	Mallra dhe shërbime	Shërbime komunale	Subvencione	Investime Kapitale	Totali
Zyra e Kryetarit	177,627	55,000		90,000		322,627
Administrata	207,217	176,167			23,000	406,384
Çështjet Gjimore	5,180	2,000				7,180
Inspektimet	74,827	20,000				94,827
Zyra e Kuvendit Komunal	102,650	23,261				125,911
Buxhet dhe Financa	104,773	128,037			50,000	282,810
Shërbime publike	26,892	253,187	146,000		1,080,157	1,506,236
Zjarrfikësit dhe Inspektimet	139,838	21,600			10,000	171,438
Zyra Lokale për Komunitete	56,579	16,850			20,000	93,429
Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillim	68,057	40,100		60,000	960,000	1,128,157
Zhvillimi Ekonomik	48,489	15,800		20,000	177,620	261,909
Kadastri dhe Gjeodezia	62,394	17,100			30,000	109,494
Planifikimi Urban dhe Mjedis	38,985	17,800			642,471	699,256
Shëndetësia dhe Mirëqenie Sociale	1,070,240	420,000	60,000	61,000	400,808	2,012,048
Qendra për punë Sociale	98,474	10,000	4,500			112,974
Kulturë, Rini, Sport	71,004	33,500		80,000	275,628	460,132
Administrata e Arsimit	51,850	50,000			617,295	719,145
Arsimi Parafillor	44,928	21,989	3,000			69,917
Arsimi Fillor	4,123,542	278,503	50,200			4,452,245
Arsimi I mesëm	1,049,088	114,583	16,800			1,180,471
TOTAL	7,622,634	1,715,477	280,500	311,000	4,286,979	14,216,590

Tabela 5: Shpenzimet për 2022, të shpërndara në kategori ekonomike në programe dhe nën programe:

Programe	Paga	Mallra dhe shërbime	Shërbime komunale	Subvencione	Investime Kapitale	Totali
Zyra e Kryetarit	174,457.00	55,000.00		129,000.00	-	358,457.00
Administrata	216,182.00	176,000.00			20,000.00	412,182.00
Çështjet Gjinore	5,281.00	2,000.00			-	7,281.00
Inspektimet	71,097.00	15,000.00			20,000.00	106,097.00
Zyra e Kuvendit Komunal	106,593.00	20,000.00			-	126,593.00
Buxhet dhe Financa	99,337.00	130,000.00			60,000.00	289,337.00
Shërbime publike	27,504.00	255,981.00	156,000.00		1,205,976.00	1,645,461.00
Zjarrfikësit dhe Inspektimet	148,586.00	15,000.00			30,000.00	193,586.00
Zyra Lokale për Komunitete	58,549.00	16,850.00			20,000.00	95,399.00
Bujqësia, Pyltaria dhe Zhvillim	64,836.00	60,000.00		40,000.00	1,400,000.00	1,564,836.00
Zhvillimi Ekonomik	43,709.00	15,800.00		20,000.00	120,000.00	199,509.00
Kadastra dhe Gjeodezia	64,047.00	17,000.00			30,000.00	111,047.00
Planifikimi Urban dhe Mjedis	40,551.00	30,000.00			900,000.00	970,551.00
Shëndetësia dhe Mirëqenie Sociale	1,076,450.00	430,000.00	50,000.00	71,000.00	394,598.00	2,022,048.00
Qendra për punë Sociale	100,780.00	10,000.00	4,000.00		-	114,780.00
Kulturë, Rini, Sport	67,034.00	45,000.00		100,000.00	250,000.00	462,034.00
Administrata e Arsimit	53,550.00	55,000.00			300,000.00	
Arsimi Parafillor	47,850.00	36,369.00	3,000.00			87,219
Arsimi Fillor	4,231,892.00	240,000.00	44,000.00		65,212.00	
Arsimi Mesëm	1,174,559.00	110,000.00	13,000.00			
TOTAL	7,872,844.00	1,735,000.00	270,000.00	360,000.00	4,815,786.00	15,053,630.00

Tabela 6: Shpenzimet , projeksionet 2023, të shpërndara në kategori ekonomike në programe dhe nën programe:

Programe	Paga	Mallra dhe shërbime	Shërbime komunale	Subvencione	Investime Kapitale	Totali
Zyra e Kryetarit	183,179.00	55,000.00		149,000.00	-	387,179.00
Administrata	226,991.00	176,000.00			20,000.00	422,991.00
Çështjet Gjimore	5,545.00	2,000.00			-	7,545.00
Inspektimet	74,651.00	15,000.00			20,000.00	109,651.00
Zyra e Kuvendit Komunal	111,922.00	20,000.00			-	131,922.00
Buxhet dhe Financa	104,310.00	130,000.00			60,000.00	294,310.00
Shërbime publike	28,879.20	255,981.00	166,000.00		1,408,225.00	1,859,085.20
Zjarrfikësit dhe Inspektimet	156,015.30	15,000.00			30,000.00	201,015.30
Zyra Lokale për Komunitete	61,476.00	16,850.00			20,000.00	98,326.00
Bujqësia, Pyltaria dhe Zhvillim	68,077.00	60,000.00		40,000.00	1,500,000.00	1,668,077.00
Zhvillimi Ekonomik	45,894.00	15,800.00		20,000.00	120,000.00	201,694.00
Kadastra dhe Gjeodezia	67,249.00	17,000.00			30,000.00	114,249.00
Planifikimi Urban dhe Mjedis	42,578.00	30,000.00			900,000.00	972,578.00
Shëndetësia dhe Mirëqenie Sociale	1,130,273.00	500,000.00	51,000.00	71,000.00	367,327.00	2,119,600.00
Qendra për punë Sociale	105,819.00	10,000.00	4,000.00		-	119,819.00
Kulturë, Rini, Sport	70,385.00	45,000.00		100,000.00	240,000.00	455,385.00
Administrata e Arsimit	56,227.45	55,000.00			300,000.00	411,227.45
Arsimi Parafillor	50,242.50	36,369.00	3,000.00		65,212.00	154,823.50
Arsimi Fillor	4,443,486.60	240,000.00	44,000.00			4,727,486.60
Arsimi Mesem	1,233,286.95	110,000.00	13,000.00			1,356,286.95
TOTAL	8,266,487.00	1,805,000.00	281,000.00	380,000.00	5,080,764.00	15,813,251.00

Tabela 7: Shpenzimet, projeksionet 2024, të shpërndara në kategori ekonomike në programe dhe nënprograme :

Programe	Paga	Mallra dhe shërbime	Shërbime komunale	Subvencione	Investime Kapitale	Totali
Zyra e Kryetarit	192,337.00	55,000.00		149,000.00	0.00	396,337.00
Administrata	238,340.00	176,000.00			20,000.00	434,340.00
Çështjet Gjimore	5,822.00	2,000.00			0.00	7,822.00
Inspektimet	78,384.00	15,000.00			20,000.00	113,384.00
Zyra e Kuvendit Komunal	117,518.00	20,000.00			0.00	137,518.00
Buxhet dhe Financa	109,519.00	130,000.00			60,000.00	299,519.00
Shërbime publike	30,323.00	255,981.00	166,000.00		1,520,000.00	1,972,304.00
Zjarrfikësit dhe Inspektimet	163,816.00	15,000.00			30,000.00	208,816.00
Zyra Lokale për Komunitete	64,550.00	16,850.00			20,000.00	101,400.00
Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillim	71,481.00	60,000.00		40,000.00	1,600,000.00	1,771,481.00
Zhvillimi Ekonomik	48,189.00	15,800.00		20,000.00	256,189.00	340,178.00
Kadastra dhe Gjeodezia	70,611.00	17,000.00			30,000.00	117,611.00
Planifikimi Urban dhe Mjedis	44,707.00	30,000.00			1,000,000.00	1,074,707.00
Shëndetësia dhe Mirëqenie Sociale	1,186,785.60	500,000.00	52,000.00	71,000.00	412,244.40	2,222,030.00
Qendra për punë Sociale	111,109.00	10,000.00	4,000.00		0.00	125,109.00
Kulturë, Rini, Sport	73,904.00	45,000.00		110,000.00	240,000.00	468,904.00
Administrata e Arsimit	59,038.00	55,000.00			300,000.00	414,038.00
Arsimi Parafillor	52,754.10	46,369.00	3,000.00			102,123.10
Arsimi Fillor	4,665,660.30	262,439.30	44,000.00		65,212.00	5,037,311.60
Arsimi Mesëm	1,294,950.30	130,000.00	13,000.00			1,437,950.30
TOTAL	8,679,798.30	1,857,439.30	282,000.00	390,000.00	5,573,645.40	16,782,883.00

Kategoria Ekonomike – Investimet Kapitale - e prezantuar në detaje më lartë, paraqet një komponentë të rëndësishme të buxhetit të komunës e cila ndonëse nuk përfaqëson pjesën më të madhe të shpenzimeve të përgjithshme buxhetore, mbetet me rëndësi të posaçme në aspektin e planifikimit për Komunën e Rahovecit. Kjo kategori e shpenzimeve në kuadër të shpenzimeve të rregullta buxhetore ka potencialin më të madh për të nxitur rritjen ekonomike. Prandaj, kjo kategori e shpenzimeve edhe gjatë periudhës së ardhshme afatmesme, do të vazhdojë të jetë në funksion të krijimit të ambientit më të favorshëm për ngritje të pjesëmarrjes së sektorit privat, përmes përmirësimit të vazhdueshëm të infrastrukturës. Përderisa ndikimi i këtyre investimeve

në punësim dhe konsum është relativisht i shpejtë, ndikim i plotë i tyre në ekonomi do të mund të realizohet vetëm në periudhën afatmesme. Në këtë kontekst përmirësimi i infrastrukturës do të pozicionojë ekonominë e komunës së Rahovecit në një rrugë të rritjes më të shpejtë dhe të qëndrueshme ekonomike në periudhën afatgjatë.

3.4 Analiza Gjimore

Komuna nuk ka përgatitur një buxhet të përgjegjshëm gjinor të detajuar, por jemi përpjekur për të vlerësuar se si shpenzimet në paga dhe mëditje janë ndarë për të adresuar planifikimin e ardhshëm buxhetor. Ne kemi analizuar numrin e grave dhe burrave, djemve dhe vajzave të punësuar në kuadër të komunës, dhe i paraqesim këtë informacion në tabelën e mëposhtme:

Sqarim: Tabela e më poshtme bazohet në shifrat sipas listës së Pagave dhe Mëditjeve, të qershorit 2021 dhe numrin aktual të të punësuarve.

Tabela 8: Struktura e të punësuarve sipas gjinisë

Tabela 1.

Numri i punëtorëve në Organizatën Buxhetore

Emri i institucionit

Viti	Numri total i stafit	Numri total i stafit - gra	Numri i stafit - burra	Paga dhe mëditje/Shuma për gra	Paga dhe mëditje/Shuma për burra
2020	1186	437	749	2,607,464.28	4,399,946.88
2021	1186	476	710	1.413.872.58	2.146.315.82
Planifikimi 2022					

Tabela 2. Planifikimi për vitin 2022 Nivelet e pagave në Organizatën Buxhetore

Emri i institucionit

Niveli i pagave	Numri i total i stafit në këtë nivel të pagave	Numri i burrave në këtë nivel	Shuma e shpenzuar për burra në këtë nivel	Numri i grave në këtë nivel	Shuma e shpenzuar për gra në këtë nivel
201-400	255	185	811,423.44	70	394,595.16

401-600	849	478	3,056,012.28	371	2,336,164.92
600+	113	95	938,167.44	18	180,575.04

Tabela 3. Numri i përfituesve të subvencioneve apo edhe të shërbimeve ofruara nga organizata buxhetore të drejtorive përkatëse (ku është e aplikueshme)

Viti	Buxheti total i shërbimit/subvencionit të caktuar	Numri total i përfituesve	Numri total i përfituesve - i grave	Numri total i përfituesve për burra	Buxheti për gra	Buxheti për burra
2020	320,532.48	635	251	384	112,186.37	208,186.00
2021	311,000.00					
Planifikimi 2022	360,000.00					

-Komuna do t'i përdor më pas të dhënat specifike gjinore që janë në dispozicion për të vlerësuar ndikimin gjinor në **paga dhe mëditje** në buxhetet e vitit 2021 për të përgatitur buxhetin në të ardhmen duke respektuar buxhetin e përgjithshëm gjinor. Tek investimet kapitale, kur një projekt është për një qytet të caktuar apo të një fshati, për një rrugë, gypat e ujësjellësit, qendër shëndetësore etj. ne do të përdorim të dhënat e ndarjes së popullsisë në mes të grave, burrave, vajzave dhe djemve për atë zonë; Kur një projekt është për një shkollë të veçantë ne do të përdorim numrat e nxënësve: meshkuj dhe femra; Kur një projekt ndikon në tërë komunën (duke përfshirë projektet për administratën komunale) ne përdorim analizën e përgjithshme të popullsisë nga viti 2011.

Drejtoria për Buxhet dhe Financa

Kryetari i Komunës